

Hapet thirrja për aplikime për bursa për studentët dhe stafin akademik më kohë të plotë të Universitetit të Tiranës në Universitetin Masaryk në Republikën Çeke, për vitin akademik 2020-2021.

Në kuadër të programit Erasmus+ është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për studentët dhe stafin akademik me kohë të plotë të Universitetit të Tiranës në Universitetin Masaryk në Republikën Çeke për vitin akademik 2020-2021.

<https://www.muni.cz/en>

Llojet e mobilitetit përfshijnë:

- Shkëmbimin e studentëve për studime;
- Shkëmbimin e stafit akademik me kohë të plotë për mësimdhënie,

Kohëzgjatja e bursave:

- Bachelor (1 semestër);
- Master (1 semestër);
- PhD (1 semestër);
- Staf për mësimdhënie (5+2 ditë);

Fushat e studimit:

Për t'u njohur me katalogun e programeve të studimit të ofruara nga Universiteti Masaryk për studentët klikoni në adresën:

<https://czs.muni.cz/en/student-from-abroad/international-student-guide/course-catalogue>

Për më shumë informacion për mobilitetet për mësimdhënie klikoni në adresën:

<https://czs.muni.cz/en/staff-from-abroad/teaching-at-mu/erasmus-icm>

Bursat përfshijnë:

- Kompensimin mujor (800 EUR në muaj për studentët);
- Kompensimin ditor (140 EUR në ditë për stafin);
- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës)

DISTANCA E UDHËTIMIT (http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)	Kompensimi
Midis 100 dhe 499 KM	180 EUR
Midis 500 dhe 1999 KM	275 EUR
Midis 2000 dhe 2999 KM	360 EUR
Midis 3000 dhe 3999 KM	530 EUR
Midis 4000 dhe 7999 KM	820 EUR
8000 KM ose më shumë	1100 EUR

Për të përcaktuar distancën ju lutem referohuni:

http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm

Studentët që përfitojnë nga mobiliteti Erasmus+ nuk do të paguajnë asnjë tarifë për shkollim në universitetin pritës. Studentët do të vazhdojnë të paguajnë shkollimin e tyre dhe/ose tarifat e regjistrimit në universitetin e tyre të origjinës.

I gjithë aplikimi është online.

Për të aplikuar online klikoni në linkun:

<https://isois.ois.muni.cz/en/incoming-application/application/>

Dokumentet e nevojshme për aplikim për studentët i gjeni në linkun:

<https://czs.muni.cz/en/student-from-abroad/exchange-non-degree-studies/erasmus-icm#application-process>

*Lista e notave që duhet të bashkëngjisni, duhet të jetë në gjuhën shqipe dhe e përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze (të ngarkohet si një dokument i vetëm).

Dokumentet e nevojshme për aplikim për stafin akademik i gjeni në linkun:

<https://czs.muni.cz/en/staff-from-abroad/teaching-at-mu/erasmus-icm#application-requirements>

Afati për aplikim: **15 Mars 2020**

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në Zyrën për Marrëdhëniet me Jashtë në adresën: iro@unitir.edu.al.

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikimin tuaj!